

RENDI I DITËS

*Projektvendim "Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr. 30, objekti kundërshtimin
e vendimit nr. 157, dt. 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

Subjekti ankues partia politike "Lëvizja Bashkë".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Horanlliu
- **Parti Politike:** Partia "Lëvizja Bashkë" (A. Qori) (J.Marka)

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Çelim seancën për shqyrtimin me themel të Kërkesës Ankimore me nr. 30, të paraqitur nga subjekti politik partia "Lëvizja Bashkë", e përfaqësuar nga zoti Arlind Qori. KAS dje mori vendim të ndërmjetëm, vetëm për kalmin në seancë të shqyrtimit të këtij ankimi. Fillimisht dëshiroj të verifikoj prezencën. Është prezent në përbërje të plotë trupa e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i palës ankimore dhe po ashtu është prezent Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së që më këtë procedim administrativ përfaqëson Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Objekt i këtij ankimi është kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 157, dt. 09.03.2023 për mosregjistrimin e subjektit politik "Lëvizja Bashkë" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Atëherë pa humbur kohë dëshiroj që sipas procedurës ti jap fjalën përfaqësuesit të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

palës ankuese që të parashtrojë shkurtimisht faktet, argumentat dhe provat sigurisht nëse ka në mbështetje të kërkesës së tij. Fjala për ju.

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Ju faleminderit! Partia “Lëvizja Bashke” ka dorëzuar në Gjykatën e Tiranës firmat e mbi 3500 (tre mijë e pesëqind) qytetearëve. Në datën 9 shkurt Gjykata e Tiranës kishte detyrimin që të merrte vendimin për njohjen e Lëvizjes Bashkë. Një vendim të tillë Gjykata e Tiranës e ka marrë në 2 mars duke shkelur pa asnjë arsye ligjin, afatet e përcaktuara nga ligji i partive. Gjithsesi në datën 6 mars kemi dorëzuar në KQZ gjithë dokumentacionin që sipas interpretimit tonë i përmbush kriteret për ta regjistruar partinë në këto zgjedhje. Pretendimi i KQZ-së është që dokumenti, ose vendimi që ne kemi marrë nga gjykata, nuk është vendimi i formës së prerë, ndonëse në asnjë prej neneve të Kodit Zgjedhor apo të ligjit të partive, nuk kërkohet që vendimi të jetë i formës së prerë. Në mendimin tonë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, le të themi e ekzagjeron me interpretimin e tij, atëherë kur e konsideron regjistrimin sikur ndodh pas 15 ditësh, pra në momentin që partia formalisht shkruhet në regjistrin e partive. Unë përveç argumenteve të paraqitura me shkrim do të dua të shtoj dy argumenta të tjera ligjore. Nëqoftëse ne i referohemi nenit 9 të ligjit të partive thuhet diku aty se partia politike njihet si person juridik që nga data që gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Pra flitet për një datë dhe flitet për dy procese që në interpretimin tonë janë të barasvlefshme. Po lexoj komentimin tim, “Nëse ligjvënësi do ti kishte konsideruar dy shkallë të dallueshme miratimin dhe regjistrimin e një partie politike atëherë do të shprehej se partia do të konsiderohej person juridik në datën e dytë të mëvonshme, atë të regjistrimit të saj. Meqenëse flitet për një datë, atëherë miratimi dhe regjistrimi konsiderohen të barasvleshëm dhe në të njëjtën datë. Kësisoj partia

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

konsiderohet person juridik dhe i regjistruar që nga data e miratimit të saj, në rastin tonë data 2 mars. Çka shprehet edhe në shkurtimvendimin që ne ju kemi paraqitur, të marrë në datën 2 mars. Nga ana tjetër dua të tërheq vëmendjen tuaj për nenin 15, të ligjit të partive, ku çështja shprehet akoma edhe më qartë. Neni 15 i ligjit të partive thotë “Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në Gjykatën e Apeilit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës”. Ky nen tregon se gjykata e konsideron të regjistruar partinë që prej momentit të miratimit të saj. Ajo mund ta çregjistrojë partinë pas një ankimimi, por deri në bërjen e ankimimit dhe një vendimi të ri nga ana e gjykatës, partia konsiderohet e regjistruar. Sipas këtij interpretimi që ne mendojmë se është i sakti, partia “Lëvizja Bashkë” konsiderohet e regjistruar nga gjykata e Tiranës dhe interpretimi që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i bën nenit 64, pika 2 është i padrejtë. Ne kemi edhe një argument tjetër, përsëri juridik, që ka të bëjë me një precedent të vendosur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2019, ku ka konsideruar të regjistruar dhe ka regjistruar në zgjedhje Partinë Bindja Demokratike në kushte të ngjashme me ne, kur nuk është marrë ende vendimi i formës së prerë, madje ku, le të themi Partia Bindja Demokratike nuk ka qenë as viktimë e një paligjshmërie si ne. Dua t’ju kujtoj edhe njëherë faktin që partia “Lëvizja Bashkë” duhej të ishte regjistruar tërësisht nga Gjykata e Tiranës që në datën 9 shkurt. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ne na heq të drejtën kushtetuese të marrjes pjesë në zgjedhje dhe na ndëshkon për një faj që nuk e kemi bërë ne. Pra edhe sikur të qëndrojë, që për mendimit tonë nuk qëndron interpretimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kjo vendos një masë mbi një subjekt politik për në përgjegjësi që nuk është e atij subjekti politik. Nga ana tjetër mosregjistrimi ynë në zgjedhje do të sillte një dëm, i cili është i parikuperueshëm. Çfarë do të thotë i parikuperueshëm.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

Ky nuk është një dëm financiar që mund ti drejtohem gjykatës apo dikujt tjetër që të na zhdëmtojë. Ky është një dëm politik. Moslejimi i një partie të marrë pjesë në zgjedhje është një dëm politik i cili është i parikuperueshëm. Pra nuk mund të ndodhë, si të thuash që institucionet të na thonë, “ Po mirë do të keni të drejtë në zgjedhjet e ardhshme”. Nëqoftëse nuk na lejojnë jashtë ligjit, për interpretimin tonë, të marrim pjesë në këto zgjedhje, ky është një dëm i parikuperueshëm, nuk është për fajin tonë e kësaj për mendimin tim paligjshmëria në rast të ndalimit tonë, do të ishte e disafishtë. Këto janë argumentet tona paraprake. Jua kemi dërguar më të detajuara në materialin që kemi depozituar. Për çdo pyetje jemi të hapur.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Po ja jap fjalën përfaqësuesit të Komisionerit, Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së dhe pastaj në fund, nëse do të ketë pyetje nga kolegët mund të vijojë. Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Po faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 09.03.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën e partisë politike “Lëvizja Bashkë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 157, dt. 09.03.2023 ka vendosur mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Lëvizja Bashkë” me kryetar zotin Arlind Qori, me shkronjat listore bashkë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Duke argumentuar se partia “Lëvizja Bashkë” ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shkurtimin e vendimit nr. 2, dt. 02.03.2023 nënshkruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilën vërtetohet regjistrimi i saj në gjykatë. Në përmbajtje të dispozitivit gjykata shprehet se ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim në

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

Gjykatën e Apelit, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij. Referuar nenit 9 të Ligjit të Partive Politike regjistrimi i partive politike bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrimit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues, shënime për ndryshimin e emrit, etj. Referuar kësaj dispozite Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur në përmbajtje të dispozitivit që ky vendim nuk ka marrë formë të prerë, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nuk është pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me këtë arsyetim Komisioneri ka vendosur mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë "Lëvizja Bashkë", faleminderit.

Z. E. Çefa: Falemiderit zoti Merkaj! Ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. K. Beke: Zoti Merkaj kisha një pyetje për ju. Duke qenë se u citua precedenti i vitit 2019 për regjistrimin e subjektit Bindja dhe nuk i kemi parë procesverbalet e seancës, kështu që do të ju luteshim të na e jepnit. Në kuptueshmërinë timë është referuar Komisioneri edhe tek një precedent i vitit 2015, mund të na elaboroni diferencën midis këtyre dy rasteve dhe përse u zgjodh kjo? Në dijeninë tuaj, pra a ka një analizë ku dallojnë këto raste dhe pse pikërisht u zgjodh ky qëndrim nga ana e Komisionerit?

Z. Y. Merkaj: Duhet të them që precedenti në legjislacionin shqiptar nuk njihet. Ka patur dy raste të tilla 2015, 2019. Komisioneri është organ tjetër. Ka gjykuar që

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që tregon për regjistrimin e partisë politike është një dokument dhe një element skualifikues për partinë, kështu që e ka gjykuar, e ka menduar mos ta regjistrojë.

Z. K. Bele: Një pyetje për zotin Qori. Në dijeninë tuaj përse nuk u arrit të merrej vendimi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë brenda 30 ditëve dhe a janë bërë përpjekje nga ana juaj për ta përsheptuar apo vënë në lëvizje apo kërkuar një datë. Pra, çfarë mund të provoni për sa ju thatë?

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike "Lëvizja Bashkë": Ne mund t'jua rijapim dokumentin që ju kemi paraqitur ku dokumentojmë se si në data të ndryshme ne i kemi drejtuar me shkrim Gjykatës së Tiranës për tu shprehur në kohë dhe në asnjë moment nuk kemi marrë përgjigje nga gjykatësi apo gjykata se pse po vonohet dhënia e vendimit. Pra kemi disa shkresa të drejtuara Gjykatësit, zotit Zhukri përpara se të jepte dorëheqjen, kemi disa shkresa drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në asnjë rast nuk na është dhënë përgjigje me shkrim për vonesën. Sigurisht gojarisht na kanë thënë kemi shumë punë. Ne kemi këmbëngulur për faktin që po rrezikojmë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe dua t'ju kujtoj që data e parë e dhënies së vendimit, e shprehur nga zoti Zhukri ka qenë 7 marsi. Pra imagjinoni Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë fazën e parë të shqyrtimit të kërkesës sonë dhe dhënies së vendimit e ka lënë në 7 mars, ndërkohë që në 6 mars ishte afati i fundit i regjistrimit në KQZ. Si rezultat i presionit publik, i indinjatës publike Gjykatës Zhukri ka dhënë dorëheqjen dhe një gjykatës tjetër, zoti Kostandini për 24 orë ka bërë atë që zoti Zhukri nuk e ka bërë për dy muaj. Në këtë kuptim nuk di se çfarë mund të... Mund t'jua citoj edhe datat, mund t'jua lexoj edhe këtu, por i keni dhe në materialin përpara ku ne i kërkojmë Kancelarit, zotit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

Leonard Xhelili, zotit Zhukri, i drejtohem i me shkresë, zotit Kapllani, zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u drejtohem i me shkresë, duke u kërkuar të respektojnë afatet ose të paktën të na japin një argument ligjor bazuar në ndonjë rregullore se pse nuk respektohet afati. Në asnjë moment nuk kemi marrë përgjigje.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj ne nuk i kemi këto prova që sapo citoi përfaqësuesi i partisë politike. Këto shkresa. Mundësisht e gjithë praktika që ka patur Komisioneri të na vihet në dispozicion edhe ne. Gjatë hetimit administrativ tek Komisioneri i keni paraqitur këto prova, këto shkresat që i keni drejtuar gjykatës pas kërkesës së regjistrimit?

Përfaqësuese e partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Falemiderit! Gjatë kohës që ne i jemi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të njëjtën shkresë kemi vendosur në dijeni dhe Komisionerin, zotin Iirjan Celibashi. Pra, Komisioneri është në dijeni të të gjithë situatës sepse të njëjtat shkresa që i kanë shkruar gjykatës, kanë ardhur në të njëjtën kohë edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Atëherë, kam një pyetje tjetër. Duke qenë se ligji, Ligji për Partitë Politike dhe Kodi i Procedurës Civile, normalisht përcakton edhe afatin 15 ditor i cili nis nga e nesërmja e njoftimit, mund të na e konfirmoni se kur keni marrë njoftim zyrtarisht nga gjykata në lidhje me vendimmarrjen e datës 2 mars?

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Në datën 3 mars ne kemi marrë këtë shkurtim vendimi që i bie të jetë besoj përgjigjia për pyetjen tuaj.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

Z. L. Braho: Dua të di njoftimin në lidhje me vendimin sepse dua të bëj një përlllogaritje se kur përfundon afati 15 ditor. Pra kur u njoftuat që përfundon afati 15 ditor?

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Në datën 2 mars unë kam qenë në zyrën e zotit Konstandini edhe ai ka lexuar le të themi vendimin e tij. Ama me shkrim dhe vërtetimin që ju kemi dorëzuar na e ka dhënë sekretaria në datën 3 mars.

Z. L. Braho: Pra a mund të themi, me aq dijeni sa keni ju nga gjykata, që në dt. 17 mars përfundon afati i ankimeve dhe në 18 mars ky konsiderohet vendim i formës së prerë?

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Besoj se po, megjithëse 18 marsi i bie ditë e shtunë dhe kam frik se...

Z. L. Braho: Jo 17, nëse 17 është dita e fundit dhe i bie ditë e premte i bie që përfundon afati.

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Logjikisht po.

Z. L. Braho: Mund të na e konfirmoni këtë meqenëse ju i keni ndjekur procedurat në gjykatë?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Tani ketu ka 2 interpretime dhe unë nuk jam i zoti të them është data 17 apo data 18 mars. Domethënë a llogaritet data 2 kur gjykatësi ka marrë vendimin apo data 3 kur na ka dhënë...

Z. L. Braho: Vendimin e plotë e kemi marrë ndonjëherë? Jo shkurtim vendimi, vendimin e plotë të gjyqtarit Arben Konstandini, që ka pranuar kërkesën tuaj.

Përfaqësuese e partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Ne kemi dispozitivin, shkurtimin e vendimit. Ditën që është bërë seanca me zotin Arben Kostandini, na ka dhënë vendimin por që nuk është i firmosur i gjithë vendimi i plotë. Nuk është i vendosur për shkak se duhet të kalonin 15 ditë. Ideja është se 15 ditëshi, nisur nga ky afat, nisur edhe nga shkurtim vendimi që i kemi paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mund të bëhet ankimimi brenda 15 ditëve dhe ky afat fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi, ndërkohë që është shpallur në dt. 02.03.2023. Afati fillon në dt. 03.03.2023 dhe sipas përlllogaritjeve në datën 17.03.2023, në orën 14:00 mbaron afati i ankimimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Nuk kam pyetje të tjera.

Z. J. Marka, përfaqësues i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Nëse mund të shtoj diçka. Jani Marka, jam anëtar themelues i Lëvizjes Bashkë. Nuk jam jurist por duke ndjekur politikën kisha dëgjuar shpeshherë parimin drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar dhe për ironi një ditë hyra në faqen e internetit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe shikoj që kjo parrullë ishte në ballinën e saj. Në këtë kuptim dhe për sa u diskutua më herët ne këtë padrejtësi që po i bëhet Lëvizjes Bashkë e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

quajmë shumë të rëndë, duke mos u respektuar afati që ka vendosur ligji. Është shkelje e Ligjit të Partive, Kushtetuta gjithashtu. Vetëm 30 sekonda se doja të shtoja edhe diçka tjetër. Për sa u diskutua këtu nga ju, ne së pari vlerësojmë që vënia në vend e kësaj drejtësie mund të bëhet në çdo ditë përpara datës 27 mars. Qoftë edhe 1 orë pas kësaj dite për ne nuk ka vlerë përves se një dëmshpërblimi moral, por ne jemi këtu për të përfaqësuar 3500 (tre mijë e pesëqind) anëtarët tanë që kanë firmosur për themelimin e Lëvizjes Bashkë dhe aktualisht 3000 (tre mijë) qytetarë të tjerë të Tiranës. Ne kemi filluar aktualisht procesin e mbledhjes së nënshkrimeve për ti paraprirë dorëzimit të tyre në datën 27. Nëse më lejoni një koment të fundit për precedentin e Bindjes Demokratike. Mesa u tha këtu janë 2 precedentë. E thashë unë nuk jam jurst por logjika e shëndoshë ma do që precedenti fundit duhet të ketë përparësi karshi një precedenti të mëhershëm. Ndryshe shkaktohet një kolaps juridik. Edhe në raportin e OSBE\ODIHR-it mesa kam lexuar, përmendet ky fakt. Kështu që unë dhe ne ju ftojme personalisht ta regjistroni Lëvizjen Bashkë edhe duke e marrë në konsideratë precedentin me gjithë argumentet e tjera dhe duke e konsoliduar këtë praktikë për të ardhmen dhe për mos ti penguar askujt të drejtën kushtetuese për të garuar në zgjedhje. Tek e fundit partitë krijohen për të marrë pjesë në garë elektorale, për të cuar përpara platformën e tyre. Ne kemi qenë aktivist për 12 vite, e kishim atë rrugë. Kemi zgjedhur që të përfaqësojmë tani në mënyrë institucionale mijëra anëtarë. Faleminderi!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Unë kam një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm, për administratën. Në vendimin e Komisionerit objekt ankimi përveç parregullsisë po themi të vendimit, pra të mosregjistrimit në regjistrin e partive politike, dokumentacioni tjetër që shoqëron kërkesën e partisë politike “Lëvizja Bashkë”

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.03.2023*

për tu regjistruar si subjekt zgjedhor ka mangësi, apo është i plotë? Pra, ta formuloj ndryshe. Nëse prezumojmë që regjistrimin do ta kishim, janë të gjitha dokumentet e tjera të plotësuara konform nenit 64 të Kodit Zgjedhor?

Z. Y. Merkaç: Po të gjitha janë të plotësuara, por sikur edhe një element të mungojë për ne është skualifikuese.

Z. E. Çefa: Qartë, faleminderi! Pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Atëherë shkurtimisht ju ftoj të paraqitni konkluzionet përfundimtare, pra në përfundim zoti Qori çfarë kërkoni nga KAS?

Z. A. Qori, kryetar i partisë politike “Lëvizja Bashkë”: Ne kërkojmë nga KAS-i të regjistrojë subjektin “Lëvizja Bashkë” si parti politike për zgjedhjet e datës 14 maj bazuar në gjithë dokumentacionin dhe argumentet që parashtruam më herët.

Z. E. Çefa: po faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaç: Rrëzimin e kërkesës, mospranimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke mos e regjistruar si subjekt zgjedhor partinë “Lëvizja Bashkë”.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë ne do të tërhiqemi për vendim, do ju kërkojmë ndoshta 30 minuta kohë dhe më pas do të ju ftojme që të shpallim vendimin. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.14.03.2023

Rifillon seanca

Ora 09:58

Z. E. Çefa: Atëherë çelim seancën për shpalljen e vendimit, për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore me numër 30. KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi me shumicën e votave vendosi:

1. Rrëzimin e ankimit të partisë “Lëvizja Bashkë” .
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 157, dt. 09.03. 2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 23

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

